



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 93, Datë 13.05.2024

MBI

**ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S PËR
APLIKIMIN E SHOQËRISË “FU-GEN” SH.P.K. PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.05.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 886/5 prot., datë 10.05.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “FU-GEN” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “FU-GEN” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 886 prot., datë 04.04.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 62, datë 12.04.2024 vendosi të fillojë procedurën për licencim e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 13.04.2024 dhe 14.04.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 22.04.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e kësaj procedure u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me shkresën nr. 886/3 prot., datë 22.04.2024, ERE ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës dhe i ka evidentuar informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet ende në aplikimin e saj.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 886/4 prot., datë 02.05.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit. Pas shqyrtimit të këtij dokumentacioni, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, rezulton se nevojitet të depozitohet dhe sa vijon:
 - vërtetimi i gjendjes gjyqësore për shoqërinë “FU-GEN” sh.p.k. (neni 9, pika 1.2, gërma “b”);
 - dokumentacioni mbështetës financiar për vlerën e mbetur të investimit që rezulton nga kontrata me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (neni 9, pika 1.3, gërma “b”);
 - korrigjimi i kapacitetit të instaluar dhe plotësimi i të dhënave në lidhje me kapacitetin e secilës prej njësisë gjeneruese (neni 9, pika 2.1, gërma “a”);
 - informacion mbi fillimin e punimeve për ndërtimin e impiantit fotovoltaik në kuadër të vlefshmërisë së VNM-së Paraprake (neni 9, pika 2.1, gërma “e”).
- Në nenin 14, pika 3 të Rregullores parashikohet se *Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.*
- Me qëllim që t’i lihet kohë shoqërisë për të depozituar dokumentacionin që ka mbetur ende për t’u plotësuar dhe depozitim e tij në vijim në ERE, vlerësojmë të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë “FU-GEN” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë “FU-GEN” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
2. Brënda 20 (njëzet) ditëve nga marrja e këtij vendimi, shoqëria të depozitojë në ERE dokumentacionin e munguar.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “FU-GEN” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI